

PAKETA FISKALE

Përmbajtja :

A. Mbi Bashkinë Rrogozhine

Kapitulli I: Taksat vendore 1

1.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.....3

1.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.....4

a-Taksa mbi ndërtesat

b-Taksa mbi tokën bujqësore c-Taksa mbi truallin

..... 6

1.3. Taksa e tabelës9

1.4 Taksa e fjetjes në hotel10

1.5 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme..... 11

1.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.....12

1.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare..... 12

1.8 Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (tel., energji, TV kabllor, Internet).. ..13

1.9 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja14

Kapitulli II: Tarifat vendore.....15

II. 1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhetarifa e shërbimeve publike

Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit 18

11.2 Tarifë “Tregu i lirë”18

11.3 Niveli i tarifës për ujitjen e tokës bujqësore 19

11.4 Tarifa e parkimit të automjeteve19

II. 11 Niveli i tarifës për dhenie të licencës për tregtimin e naftës bruto e nën prod. të saj.20

Niveli i Taksave dhe Tarifave vendore për kategori * Familje* 21

Kapitulli III Gjoha22

IV.1 Gjoha për mosshlyerje në afat të detyrimit.....

IV.2 Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative

Kapitulli IV Lehtësirat fiskale26

A. Mbi Bashkinë Rrogozhine

Reforma territoriale e aplikuar në vitin 2015, solli ndryshime edhe për kufijtë territorial të Bashkisë Rrogozhine, duke përfshirë brenda saj territore tërësisht të ndryshme nga përbërja administrative, kulturore, sociale etj. Lidhur me këto ndryshime, lindi domosdoshmëria e krijimit të raporteve ndërmjet zonave në fushat e ndryshme administrative, në ruajtjen e këtyre traditave, territoreve produktive në aspektin bujqësor, në ruajtjen dhe mirëadministrimin e pyjeve, kullotave etj. Gjithashtu, për të qenë sa më pranë banorëve si dhe për të krijuar mundësi të barabarta të përfitimit të shërbimeve publike, u studiuam me prioritet llojet dhe nivelet e taksave dhe tarifave me qëllim aplikimin dhe shpërndarjen në mënyrë sa më të drejtë të tyre. Bashkimi i këtyre njësive, brenda një të vetme, edhe pse në fazat e para e të funksionimit të tyre ka krijuar një harmoni të plotë në drejtimin e të gjitha problematikave lidhur me këto njësi. Tashmë Bashkia Rrogozhine në tërësinë e saj, është përkushtuar për arritjen e objektivave për realizimin e të ardhurave si dhe në shpërndarjen sa më të drejtë të buxhetit për çdo njësi administrative.

Sipas Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës nr.1, të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

|

Tabelë 1. Ndarja në lagje dhe fshatra në njësitë administrative

NR	NJËSI ADMINISTRATIVE	LAGJE / FSHATRA
1	Njësia administrative Rrogozhine	Lagj e Nr.1, Lagj e Nr.2, Koder, Cete,Perparim,Poligon,Stacioni trenit,Shimeve,Cameve
2	Njësia administrative Gose	Gose Qender,Kercukaj,Gose Madhe,Gose e Vogel,Kalush,Ballaj,Vile Bashtove.
3	Njësia administrative Lekaj	Luz i Madh,Shkozet,Lekaj, Harizaj,Kryeluzaj,Germej,Okshtun,Zanbishe, Mushnike,Mlik.
4	Njësia administrative Kryevidh	Domen,Kazie,Spanesh,Sterbeg,Spille,Greth,Shardushk , Kryevidh ,Rreth Greth,Ballaj,Zhabjak,Patk Milot.
5	Njësia administrative Sineballaj	Sineballaj,Hasdushk,Methasanaj,Hamenraj,Kocaj, Thartor,Rrostej, Fliballie,Demarke.

I.1 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me mbi 5 (pese milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

> **Baza e taksës/tatimi:** Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pese) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon :

Tabelë 2. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Shkalla tatimore	Njësia	Shkalla tatimore	
		<i>Nj.A.Rrogozhine</i>	<i>Nj.A të tjera</i>
A. Me qarkullim vjetor nga 0 – 5.000.000 lekë	lekë/vit	0	0
B Me qarkullim vjetor nga 5.000.000 - 8.000.000 lekë	lekë/vit	5 % e fitimit	5 % e fitimit

> **Mënyra e pagesës:** Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

> **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tatimit:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

> **Struktura përgjegjëse për kryerjen e akt-rakordimeve:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjëse për rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Durrës.

> **Baza Ligjore:** Ligji 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 5, 6 dhe 7.

I.2 Taksa mbi pasuritë e paluajtshme

> Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa.

Në rastet kur ndërtesa apo/dhe truallli janë dhënë në përdorim(me qira), për subjektin sipërfaqja e shënuar në kontratë shërben si sipërfaqe e taksueshme. ***Detyrimi për pagesën e taksës së ndërtesës apo/dhe truallit i përket përdoruesit/subjektit që ushtron aktivitetin, pavarësisht marrëveshjeve midis dy palëve.***

Në rastin kur një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie apo komune, pavarësisht vendbanimit të pronarit të kësaj prone, secila njësi vendore trajton atë pjesë prone e cila ndodhet brenda juridiksionit të saj, si prone më vete dhe zbaton mbi të dispozitat ligjore përkatëse.

Në taksën mbi pasuritë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

> **Baza Ligjore:** Ligji 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 8 , 9,10,11 dhe 12

a- Taksa mbi ndërtesën

> Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, të cilët janë pronarë apo përdorues ndërtesash në territorin e administruar nga Bashkia. Baza e taksueshme është sipërfaqja e ndërtimit në metër katrorë e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si më poshtë vijon:

Tabelë 3. Nivelet e taksës së ndërtesës sipas kategorive

Nr.	KATEGORITË E NDËRTESAVE	NIVELI ■ TAKSËS (lekë/m²/vit)	NIVELI ■ TAKSËS (lekë/m[^]/vit)
■	Ndërtesa të tjera sipas njësive	Nj.A Rrogozhine	Nj.A të tjera
	1a)Ndërtesa për tregti ,shërbime,profesione të lira Biznes i Vogel.	200	100
	1b)Ndërtesa për tregti ,shërbime,profesione të lira Biznes i Madh.	200	100
	2)Ndërtesa Banimi para vitit 93	5	2.5
	Pas vitit 93	6	3
	3)Ndërtesa pa aktivitet, të amortizuara,të pashfrytëzuara,etj.,të ngjashme	40	20

Taksapagues të taksës mbi ndërtesat, janë të gjithë subjektet persona fizikë apo juridikë, vendas dhe të huaj, që kanë në pronësi apo përdorim ndërtesa.

> **Në kategorinë “Ndërtesa për tregti dhe shërbime”**

-Ndërtesa për shërbime tregtare, profesione të lira etj. të ngjashme me to: Do të përfshihen të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, banka, zyra, farmaci, klinika, spitale, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, stadiume, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura dhe njësi tregtare dhe shërbimi të çdo lloji etj. të ngjashme me to.

- Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznes

“Të tjera”: Përfshihen të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme:

- Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve; do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizatave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë.
- Ndërtesa për aktivitete social-kulturore, arsimore e shkencore: përfshihen të gjitha ndërtesat njësitë e shërbimit si shkollat, kopshtet, çerdhet, qendrat kulturore, qendrat sociale, ndërtesat shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, sallat e koncerteve, etj.
- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet ,do të përfshihen të gjithë objektet të cilat janë kapital i ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qenë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetërore:

> **“Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese”**

- “Ndërtesaprodhimi” do të përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues të tilla si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj., shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si taksëpagues personin fizik apo juridik që ushtron aktivitet, pavarësisht pronësisë së objektit.

V Arkëtimi i taksës së ndërtesës.

Si bazë për llogaritjen e detyrimit për këtë taksë për subjektet shërben sipërfaqja në m² e shfrytëzueshme për qëllime aktiviteti. Kur biznesi i krijuar (regjistruar) gjatë vitit merr në përdorim ndërtesa të krijuara në vitet paraardhëse, taksa e ndërtesës llogaritet dhe arkëtohet e plotë si detyrim vjetor, pavarësisht nga data e regjistrimit të tij. Në rastet kur kjo taksë është paguar njëherë dhe vërtetohet me mandat pagese, në Zyren e Taksave dhe Tarifave Vendore bëhet paraqitja e dokumentit të arkëtitimit të taksës për ndërtesën, zbritet detyrimi për vitin kalendarik dhe vendoset në dosjen e biznesit.

Taksa për ndërtesat arkëtohet nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore së bashku me taksat dhe tarifatat e tjera, jo më vonë se data 20 Qershor i vitit kalendarik.

4- Përfshihen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) Pronat e shtetit dhe të njërive vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
 - b) Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuar;
 - c) Ndërtesat që shfrytëzohen nga komunitetet fetare;
- > **Baza ligjore:** Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 22 “Taksa mbi ndërtesat”; ligji nr.181/2013, datë 28.12.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; Ligjin 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,” Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 10.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat bashkë me nënkategorizimet është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhine si dhe Zyrat e Taksave pranë Njërive Administrative.

b-TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

> Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Afati për shlyerjen e kësaj takse është brenda datës 20 Qershor të vitit kalendarik.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon :

Tabelë 4. Nivelet e taksës mbi tokën bujqësore

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Njësia e matjes	Niveli i taksës
I	lekë/hektar/vit	5600
II	lekë/hektar/vit	4900
III	lekë/hektar/vit	4200
IV	lekë/hektar/vit	3600
V	lekë/hektar/vit	3000
VI	lekë/hektar/vit	2400
VII-X	lekë/hektar/vit	1800

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Pagesat e taksës së tokës bujqësore do të kryhen dhe përlllogariten në masën 70 % të vlerës sipas kategorisë së tokës bujqësor kur paguhen mbrenda dt.30 Mars te vitit pasardhes.

4- Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

> **Baza ligjore:** Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 “Taksa mbi tokën bujqësore”, ANEKSI 2 , ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 9 dhe 11.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike; Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhine si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

c- Taksa mbi truallin

> “**Truall**” është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Afati i pagesës së taksës së truallit për qëllime biznesi është data 20 Qershor e vitit kalendarik.

Tabelë 5. Nivelet e taksës mbi truallin

Lloji taksës	Vlera e taksës në lekë/m²/vit për qëllime biznesi	Per Banim
A. Taksë trualli	12 lekë/m²	0.14 lek/m

> **Baza ligjore:** Ligji 142/2015, datë 21.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9632, datë 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 2 dhe neni 23/1 “Taksa mbi truallin”, ANEKSI 2.1

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për qëllime biznesi është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhine si dhe zyrat e taksave pranë Njërive

Administrative.

I.3 Taksa e tabelës

> **Taksa e tabelës** aplikohet për subjektet tregtare që ushtrojnë veprimtari nën juridiksionin e Bashkisë Rrogozhine dhe vendosin emërtimin/ emrin apo çdo të dhënë tjetër, në njësinë ku ata zhvillojnë aktivitet apo jashtë saj. Baza e taksës së tabelës është çdo tabelë e standartizuar, ku identifikohet emri dhe aktiviteti i subjektit fizik apo juridik. Taksa e tabelës paguhet nga çdo person fizik e juridik dhe për çdo njësi apo filial.

Taksa arkëtohet së bashku me taksat dhe tarifatat e tjera vendore jo më vonë se data 20 Qershor e vitit kalendarik.

Nivelet e taksës së tabelës për qëllime identifikimi

Tabelë 6.

		Shkalla tatimore	
		<i>Nj.A Rrogzhin Nj.A të tjera</i>	
1) Tabelë për qëllime identifikimi:	Njësia		
a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	lekë/ vit	0	0
a.1) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	lekë/m ²	45 000	45 000
b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	lekë/vit	120	120
2) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:	Njësia	Shkalla tatimore	
		<i>Nj.A Rogozhin Nj.A të tjera</i>	
a) Tabelë e thjeshtë	lekë/ m ² /vit	13500	13500
b) Tabelë elektronike	lekë/ m ² /vit	27000	27000

Sqarim: Për të gjitha tabelat për qëllime identifikimi apo reklamimi të cilat ndodhen jashtë territorit të objektit ku zhvillohet aktiviteti, subjekti paraqet kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila pasi shqyrton kërkesën e subjektit për leje, vendos për dhënien e saj ose jo. Në lejen e lëshuar detyrimisht përcaktohen vendi i ndodhjes, lloji i tabelës, përmasat etj. Një kopje e lejes së lëshuar dorëzohet në Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore. Kjo e fundit përlllogarit dhe ndjek arkëtimin e taksës së reklamës/tabelës për vitin kalendarik nga muaji korent i vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

- Taksa e reklames 13.500 leke m²/vit paguhet deri me 18m², ndersa per siperfaqet me te medha se 18m² paguhet 243.000 leke/vit
- Tabele ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura, panaire, spektakle, stenda rreklamuese, banderola, etj paguhet 1000lek m²/dite

Struktura e ngarkuar për evidentimin dhe kontrollin është Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Policinë Bashkiake.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës/reklamës është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Rrogzhine si dhe zyrat e taksave pranë njesive vendore.

I.4 Taksa e fjeties në hotel

> Me “**Hotel**” do të kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin njërin ose disa nga emërtimet së bashku: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, pavarësisht emërtimit që mban.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person .

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Tabelë 7. Nivelet e taksës së fjetjes në hotel

Emërtimi	Nivelet e taksës
A. Hotelet 4-5 yje	105 lekë/netë fjetje/person
B. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë/netë fjetje/person

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. Për Drejtorinë e Taksave njihet si tatimpagues pronari i hotelit ose sipas rastit personi që ka të regjistruar aktivitetin dhe likuidimi i kësaj takse bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

> **Baza ligjore:** Ligjin 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,” Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 13 “Taksa e fjetjes në hotel”, ANEKSI 8.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rogozhine si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

I.5 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

> Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

TABELA 8

Shkalla tatimore

A. Ndërtesa banimi

B. Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime

C. Ndërtesa të tjera

D. Pasuri të tjera të paluajtshme

Njësia	Shkalla tatimore	
	<i>Nj.A Rrogozhin</i>	<i>Nj.A të tjera</i>
lekë/ m ²	100	100
lekë/ m [^]	300	300
lekë/ m [^]	200	200
	2 % e vlerës së shitjes	

1- Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshimet përkatëse;
- subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.

> Baza ligjore: Ligji 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 28 "Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme" dhe ANEKSI 3 (ndryshuar me ligjin nr.142/2015)

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agentit tatimor, të cilat përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

> Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblihet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. 18% e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisive të qeverisjes vendore përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësisive të qeverisjes vendore.

> **Baza ligjore:** Ligji Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, neni 4, pika 3. **Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në rolin e agjentit tatimor, të cilat përfitojnë 25% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.**

I.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

> Bazë e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare brenda vendit.

Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit.

> **Baza ligjore:** Ligji Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, neni 4, pika 4. **Strukturat e ngarkuara për arkëtimin e kësaj takse janë degët e doganave në rrethe, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa Drejtoritë Rajonale të Tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit nga ku 25 % e të ardhurave nga renta minerare kalojnë nëpërmjet Degës së Thesarit, në llogarinë e Bashkisë Rrogozhine.**

I.8 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

> Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Detyrimi për taksën i takon investitorit. Kur objekti, sipas projektit, ka lidhje me një nga kategoritë e cituara në tabelë, llogaritjet e kësaj takse do të bëhen mbi vlerat respektive të secilës kategori.

Tabelë 10. Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës
	<i>Në përqindje</i>
1. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.	4%
2. Objekte banimi 2-3 kt	2,5%
3. Objekte banimi ,administrative,sherbime	3%
4. Ndërtim i rrugeve kombëtare, porteve, aeroportëve, tunele, diga, në energji	0,1%
5. Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0,5%

> **Baza ligjore:** Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” ndryshuar me Ligjin Nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Ligjin 107/2015, datë

31.07.2015 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” si dhe VKM Nr.408, datë

13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë bashkë me nënkategorizimet është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Rrogozhine.

Kapitulli II:

TARIFAT VENDORE

II.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifa e shërbimeve publike për biznesin

a- **Tarifës së pastrimit** i nënshtrohen të gjithë subjektet taksapagues, persona juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Rrogozhine dhe njësive të saj administrative.

b- **Tarifa për shërbime publike** është detyrim i çdo subjekti taksapagues i cili përfiton shërbime të tilla si ndriçim, gjelbërim, mirëmbajtje të rrugëve, etj., përveç pastrimit.

Në rastin kur subjekti krijohet (regjistrohet) apo mbyllet gjatë vitit kalendarik, detyrimi për tarifën e pastrimit dhe shërbimeve llogaritet dhe arkëtohet proporcionalisht me kohën aktive të ushtrimit të aktivitetit. Afati i pagesës së këtyre detyrimeve është data 20 qershor e vitit aktual kalendarik.

Nivelet e **tarifës së pastrimit dhe tarifës së shërbimeve** për kategoritë dhe nënkategoritë biznesi i vogël dhe i madh, person juridik apo fizik si dhe institucione janë të paraqitura në tabelat si më poshtë:

Projekt-Percaktimi tarifave biznesi vogel

TABELA 11

Emertimi	Lek/vit	Tarife Pastrimi	Tarife Gjelberimi	Tarife Ndricimi
1-Shitje me Pakice				
a) Bar Kafe ,byrek,etj.		10.000	1.000	1.000
b) Bar Bufe Restorant		20.000	1.000	1.000
c) Ushqimore, minimarket, fruta perime bulmet, mish,peshk,Fastfud,Bicbar etj		20.000	1.000	1.000
d) Tregtim pjese kembimi e servis mekanik.		20.000	1.000	1.000
e) Tregtim materiale ndertimi si tulla,tjegulla Derrasa, cimento,gelqere,bloqe betoni etj.		20.000	1.000	1.000
c)Tregtim lende djegese si dru.qymyr,pelet etj		20.000	1.000	1.000
f) Tregtim plehra kimike,pesticide fara e fida		20.00	1.000	1.000
g) Tregtim paisje industriale e afrim sherbimesh per artikuj te ndryshem		20.000	1.000	1.000
2.Prodhime si me poshte: Miell per Buke e Blegt.		15.000	1.000	1.000
* Prodhime material druri e duralumini		30000	1.000	1.000
a) Prodhim e shitje buke e n/produnkte te tije		20.000	1.000	1.000
b) Grumbullim perpunim qumeshti e n/prod		20.000	1.000	1.000
c) Prodhim vaj ulliri	Lek/sez	15.000	1.000	1.000
3.Profesionet e lira				
a)Farmaci te te gjitha llojeve	Lek/vit	20.000	1.000	1.000
b)Klinika dentare,laboratir,qender mjeksor		20.000	1.000	1.000
c)Kepucar,berber,fotograf.rrobaqepes		10.000	1.000	1.000
d.Ndertues, murator etj		20.000	1.000	1.000

e. Hotele	30.000	1.000	1.000
d .Tregtim pjese e mjeteve te perdorura	20.000	1.000	1.000
f. Tregtim mjete te reja	30.000	1.000	1.000
g. Lodra uji	20.000	1.000	1.000
i. Autoshkoll	20.000	1.000	1.000

P/Paketa Fiskale Biznesi Madh Viti 2018.

TABELA 12

Emertimi	Lek/vit	Tarife Pastrimi	Tarife Gjellberimi	Tarife Ndricimi
Tarifat E Biznesit Madh				
1-Shitje me pakice e shumice				
a)Ushqimore Supermarketi		50.000	2.500	5.000
b)Njesi tregtimi vetem me shumice		50.000	2.500	5.000
d) Import-Eksport pjese kembimi auto , motorrike,etj		60.000	2.500	5.000
d)Tregtim materiale nderetimi		50.000	2.500	5.000
e) Tregetime lende djegese karborant, gaz i lengshem etj		50.000	50.000	5.000
f) Shitje automjetesh,mobileri etj		50.000	2.500	5.000
g)Tregtim plehra kimik,inpute buqesore etj		40.000	2.500	5.000
h) Tregtim paisje industriale prodhuese e makineri		60.000	2.500	5.000
2-Prodhome			2.500	5.000
a) Prodhime buke apo nenprodukte mielli		50.000	2.500	5.000
b) prodhim perpunim qumeshti		50.000	2.500	5.000
c) Prodhim per perpunim mishi e nenprodukte te tilla		50.000	2.500	5.000
d) Prodhim materiale ndertimi e inerte		60.000	2.500	5.000
e) Prodhim kanfeksione e veshmbathje etj		50.000	2.500	5.000
f) Prodhim materiale plastike		50.000	2.500	5.000
g) Prodhim dyshek,jorgane etj		50.000	2.500	5.000
h) Prodhim te produkteve te drurit e te duraluminit		50.000	2.500	5.000
3-Sherbimet				
a) Banka private apo filial te tyre		50.000	2.500	5.000
b) Kompani,Agjensi sigurimesh,Kembim valutator transport etj		50.000	2.500	5.000

c) Media televizive,Kabllor,etj		40.000	2.500	5.000
d) Sherbime postare,kompani telekomunacioni,sherbime interneti,telefoni fikse etj		50.000	2.500	5.000
e) Per cdo autoshkolle,polici private,kurse kualifikimi etj		50.000	2.500	5.000
f) Per cdo njesi edukimi si shkolla,kopshti,cerdhja,etj		50.000	2.500	5.000
g) Ndermarje sherbim Energjie,Elektrike,Ndermarje Ujsjells,etj		60.000	2.500	5.000
h) Lojre fati,lloto sport,baste sportive,etj		40.000	2.500	5.000
Biznesi me aktivitet Ndertimi				
a) Per cdo kantier ndertimi te ngritur ne raport me kohezjatje deri ne perfundim ndertimi		60.000	2.500	5.000
b) Per cdo mjet transporti me Nipt paresor apo sekondar sipas Q.K.B		50.000	2.500	5.000

II.2 Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit

Baza e taksës për zënie të hapësirës publike për zonën e plazhit është sipërfaqja në m² e vijës bregdetare, e cila shfrytëzohet nga individë apo subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim sezonal i taksapaguesit. Për shfrytëzimin e vijës bregdetare si stacione Plazhi,

- a) Per kontratat ekzistuese afati i pageses eshte data 15 maj 2018.
- b) Per lidhjen e kontratave te reja pagesa e tarifes duhet te kryhet ne te njejten kohe me nenshkrimin e kontrates nga **Bashkia**.

Tabelë 13. Niveli i tarifës së zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit

II.4- a) Zona	Niveli i taksës
A. Vija bregdetare	200 lekë/m²/ne sezon.

> **Baza ligjore:** Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3 b).

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për zënien e hapësirës publike është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve në bashkëpunim me Policinë Bashkiake.

II.3 Tarifë “Tregu i lirë”

Kjo tarifë aplikohet në zonat e konsideruara Markatë. Tarifa është detyrim ditor i çdo individit që tregon mallra për konsumatorët finalë. Individët përkundrejt tarifës pajisen me biletë nga agjenti mbledhës. Niveli i aplikuar i tarifës për Tregun e Lirë është 50 lekë/m.

Për vjeljen e tarifës “Tregu i lirë” ngarkohet taksa mbledhësi

II.4 Tarifa e parkimit të automjeteve

Tarifa e parkimit të automjeteve është detyrim i çdo individit i cili parkon në vendet e miratuara si “Parkim publik me Pagesë”. Kjo tarifë arkëtohet në momentin e parkimit dhe është **100 lekë/automjet/ditë**.

Për vjeljen e tarifës së parkimit të automjeteve ngarkohet taksa mbledhësi .

Tabelë 13/1. N> Baza ligjore: Ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, Ligji Nr.10465, date 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e

- b) Tarifë për vulosje veterinerë të bagëtive të therura ne vende të aprovuara	Njësia	Niveli i tarifës
		<i>Për çdo rast shërbimi</i>
8- për bagëti të trasha	Lekë/kokë të therur	200
9- për bagëti të imta	Lekë/kokë të therur	100
10- për derra	Lekë/kokë të therur	50
11- për shpendë	Lekë/kokë të therur	10

Shqipërisë”, Akti Normativ Nr.4 datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre” dhe Vendimin Nr.230 datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”.

Tabelë 14. Nivelet e tarifës për zënie hapësirë publike për qëllime biznesi

II.9- e) Kategori, nënkategori e taksës për zënie hapësirë publike	Njësia	Niveli i tarifës	
		Sezon Veror	Sezon Dimëror
<i>A- Njësia Administrative Rrogozhine 1-Vendosje tavolinash jashtë objektit të aktivitetit :</i>	Lekë/m ² /muaj		
a- Zona A .Brenda Qendrës së Qytetit (Zonë pedonale)		100	100
b- Zona B .Jashtë Qendrës së Qytetit (Periferi)	Lekë/m ² /muaj	50	50
2-Mallra të vendosura jashtë objektit të aktivitetit, rrethime me vazo, lulishte etj.	Lekë/m ² /muaj	100	100
3-Aktivitetet në qendër të qytetit, veprimtari promociionale, të ndryshme etj.	Lekë/m ² j	1000	1000
<i>B- Njësiti Administrative të tjera 1-Vendosje tavolinash jashtë objektit të aktivitetit .</i>	Lekë/m ² /muaj	50	50
2-Mallra të vendosura jashtë objektit të aktivitetit, rrethime me vazo, lulishte etj.	Lekë/m ² /muaj	50	50
3-Aktivitetet në qendër të qytetit, veprimtari promociionale, të ndryshme etj	Lekë/m ² /muaj	100	100
Ambulant e Rulot	a) Zona Turistike (plazhi)	sezon	25000
	b)Zona tjeter		15000

 ---Niveli i Tarifës për ujitje në tokat bujqesore.

II.9- g) Kategori, nënkategori	Njësia	Niveli i tarifës
1 - Me rrjedhje të lirë	Lekë/ha/rast ujitje	3000
2- Me rrjedhje mekanike	Lekë/ha/ rast ujitje	2000

> **Baza ligjore:** Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3 b)

Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për llogaritjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.

Tabelë 15. Nivelet e tarifës për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Rrogozhine, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

II.9- h) Tarifë për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	Njësia	Niveli i tarifës
1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante	Lekë/liçencë	1 000 000
2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë	Lekë/liçencë	100 000

> **Baza ligjore:** V.K.M Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika II.

Struktura e ngarkuar për dhënien e licencave dhe arkëtimin e tarifës për dhënien e tyre është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Tabelë 16. Nivelet e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familje”

Detyra kryesore e Bashkisë Rrogozhine është të sigurojë shërbime publike sa më cilësore, me efektivitet sa më të lartë dhe në kohë sa më të shpejtë ndaj të gjithë qytetarëve të saj per vitin 2018, Llojet e taksave dhe tarifave vendore që do të aplikohen për familjet si dhe nivelet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

III 1-Sipas Njesis Administrative	Nr familjeve	Lloji i tarifës			
		Tarife Pastrimi Lek/Vit	Tarife Gjëlberim Lek/ne vit	Tarife Ndricim Lek/vit	Tarife Varrezash Lek/vit
1-Nj.A.Rrogozhine	3530	1200	500	300	300
2-Nj.A.Gose					
Zona A.Gose Qender	1290	1200	500	300	300
Gose e Vogel,Vile Bash					
Zona B. Fshatra tjer.	510	600	300	300	300
3-Nj.A.Lekaj					
Zona A. Lekaj,Luz	1700	1200	500	300	300
madh, Germenj					
Zona B.Fshatra tjere.	430	600	300	300	300
Zona C.Mushnik, Mlik	70	0	0	0	300
4-Nj.A.Kryevidh.					
Zona A.Kryevidh,Gret	595	1200	500	300	300
Mesem,Spille.					
Zona B.Fshatra te	893	600	300	300	300
tjere					
Zona C.Kazie,Domen,	448	0	0	0	300
Spanesh,P/Milot.					
5-Nj.A.Sineballaj	141	1200	500	300	300
Zona C.Fshatra tjer.	385	0	0	0	300
SHUMA.	9992				

Baza Ligjore : Ligji 139/2015 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”, neni 9. Pika 1 .3 b)

Gjobat do të aplikohen në rastet e kundravajtjeve administrative apo shkeljeve ligjore të ndryshme brenda territorit të administruar nga Bashkia Rrogozhine. Përgjegjëse për aplikimin dhe vjeljen e këtyre gjobave do të jenë zyrat/drejtoritë të cilat i kanë nën administrim në bashkëpunim me strukturat e Policisë Bashkiake.

IV. 1 Gjoba për mosshlyerje në afat të detyrimit

Gjobat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT). Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 20 qershor e po këtij viti. Baza e llogaritjes së gjobës për mosshlyerje përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e shërbimeve, taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës, taksa e truallit, etj., sipas faturës për pagesë.

Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat deri në 20 qershor për shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 20 qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së rregjistrimit.

Tabelë 170. Niveli i gjobave për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa)

III.1- a) Kategoritë	Njësia	Niveli i gjobës
1- Gjoba për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa) brenda afatit 20 Qershor	% / ditë vonesë (jo më shumë se 365 ditë kalendarike)	0.06

> **Baza ligjore** : Ligji Nr.9920 , datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, KREU XIV, Neni 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, pika 1. Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

IV.2 Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtiet administrative

Zbatimi i gjobave të paraqitura në tabelën 33, u ngarkohet të gjitha drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake.

Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.

Nr	III.2- a) Lloji i kundërvajtjes së kryer	Masa e gjobës	Vlera e çdëmtimit për kundërvajtjen e kryer
1	Për dëmtim, çarje dhe ndotje rruge	10 000 lekë	4 000 lekë/ m ² rrugë e dëmtuar
2	Për dëmtim, çarje, ndotje trotuari	10 000 lekë	3 100 lekë / m ² trotuar të dëmtuar
3	Për dëmtim bordure	10 000 lekë	2 500 lekë / metër linear bordurë të dëmtuar
4	Për dëmtim, rrjetit të kanalizimeve, bllokim pusete	10 000 lekë	20 000-50.000 lekë / pusete të dëmtuar
5	Për vjedhje të zgarës	20 000 lekë	2 500 mijë lekë / zgarë
6	Për vjedhje kapak pusete	10 000 lekë	3 000 mijë lekë / kapak pusete të vjedhur
7	Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror	20 000 lekë	2 000 mijë lekë / lidhje
8	Dëmtimi i shtyllave	10 000 lekë	520 000 lekë / shtyllë të dëmtuar
9	Dëmtimi i ndriçuesve të qytetit	20 000 lekë	420 000 lekë / ndriçues të dëmtuar
10	Përdorimi i shtyllave si suport për reklamë	10 000 lekë	20 000 lekë /reklamë të ngjitur në shtyllë në mënyrë të paligjshme
11	Ndërhyrje në kuadrot e komandimit për ndriçimin publik	10 000 lekë	4 200 lekë / shtyllë ku është dëmtuar kuadri i komandimit
12	Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror	10 000 lekë	20 000 mijë lekë/ lidhje
13	Dëmtimi i rrjetit ajror nga punimet pa leje	10 000 lekë	5 200 lekë/ metër linear
14	Lidhjet e pamiratuara në tubacionet e ujit	10 000 lekë	2 300 lekë / metër linear ndërhyrje
15	Dëmtimi i pusetave të kanalizimit	5 000 lekë	5 000 lekë / copë
16	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	1 000 lekë / m ² - sipërfaqe të gjelbërt
17	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	6 300 lekë / m ² - sipërfaqe lule sezonale
18	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	3 900 lekë / shkurre dekorative në moshën 5 vjeç e poshtë
19	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	5 800 lekë/ shkurre dekorative në moshën 5-10 vjeç
20	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	18 900 lekë / pemë apo dru që dëmtohet deri në moshën 5 vjeçare
21	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	28 300 lekë / peme apo druri që dëmtohet deri në moshën 5-10 vjeçare
22	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	20 000 lekë	150 000 lekë /palma

23	Ushtrim aktiviteti pa leje transporti: - Motokarro - Autovetura - Furgon, minibus - Mjete me tonazh të lartë	Në bazë të ligjit nr.8378, date 22.07.1998, i ndryshuar “Kodi Rrugor	
24	Mospajisje me leje veprimtarie për servise riparim për mjetet e transportit, imbarkimin e mjeteve të transportit të difektuara, shërbime në lyerj e mjetes, shërbime lavazho, parkime, gomisteri, zdruktari e tërbime lavazh, parkime, gomisteri, zdrukthtari e të ngjashme me t	<u>10 000-20 000</u> <u>lekë</u>	
25	Mospajisje me leje për tregëtim gazetari, revista, librari	5 000 lekë -----	
26	Mospajisje me leje për tregëtim e shërbime ambulate, auto, dyqane dhe rulote	5 000 - 10 000 lekë	
27	Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti “24-orësh”	10 000 lekë	
28	Mospajisje me leje për zënien e hapësirave publike: Reklama të zakonshme Reklama elektronike	5000-10000 leke	
29	Mospajisje me leje për mjetet që trasportojnë mbetje të ngurta në qytet dhe zonat turistike	10 000 - 30 000 lekë	
30	Për vendosjen e posterave pa leje	10 000 lekë	
31	Për çdo copë posteri në pemë pa leje	5 000 lekë	
32	Për çdo dëmtim të fasadës	10 000 lekë	3 200 lekë/ m ² zhdëmtimin e fasadës së dëmtuar
33	Për vendosje tabeles, pankarta pa leje	5 000 lekë	3 200 lekë/ m ² zhdëmtimin e fasadës së dëmtuar
38	Vendosje mbishkrimesh pa leje në hapësira publike	500 lekë/m ²	
39	Hedhje e mbeturinave jashtë vëndeve të përcaktuara nga Bashkia Persona juridikë Persona fizik	10 000 lekë 500 - 1 000 lekë	

40	Lëvizja e kontenierëve të mbetjeve urbane nga vëndi i miratuar nga Bashkia: Persona juridikë Persona fizik	10 000-20 000 lekë 500 - 1 000 lekë
41	Për ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit nga inerte, apo material të tjera ndërtimore	1. Për herë të parë 5 000 lekë 2. Për raste të përsëritura 10 000 lekë
42	Mosndërtim i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane nga subjektet e ndërtimit	20 .000 lekë
43	Për rastet kur kamionët, të cilët transportojnë materiale ndërtimore, nuk janë mbuluar dhe që krijojnë ndotjen e hapësirave publike, gjatë transportimit	20 000 lekë
44	Për hedhje mbeturinave ndërtimore jashtë territorit të përcaktuar për këtë qëllim nga Bashkia: Për shoqëritë e transportit	20 000 lekë -për raste të përsëritura heqje të lejes së transportit
45	Për të gjithë ata që bllokojnë kanalet kulluese apo vaditës me ndërtime të paligjshme të çfarëdo lloji	20 000 lekë
46	Për mbrojtjen e mjedisit Mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, duke i shkarkuar në vënde jo të caktuara nga Bashkia dhe në bazë të lejes mjedisore	20 000 lekë

Sqarim: Në rastet e kundravajtjeve të qarkullimit rrugor nga kundravajtës të ndryshëm, gjobat do të vendosen nga Inspektorët e Policisë Bashkiake bazuar në Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

> Baza ligjore : Ligji Nr. 10279 datë 20.05.2010 “Përkundërvajtjet administrative” neni nr. 6, ligji nr. 8224 datë 15.05.1997 “ Për Policinë Bashkiake” i ndryshuar përkatësisht të neneve 3,4,6, ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Shërbime të ofruara nga administrata që përfshijnë: lëshimin e vërtetimeve, tërheqje dokumentacioni nga

- a- Invalidët e punës dhe të luftës me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë dhe të aftë për punë.
- b- Të sëmurët tetraplegjikë, paraplegjikë, të verbërit me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë
- c- Përfituesit e ndihmës ekonomike
- d- Pensionistë në rastin kur janë të vetëm në trungun familjar

Perjashtohet nga pagimi i takses mbi ndertesën.

- a. Taksa paguesit për kategorinë e I *Ndertesa banimi* dhe që i perkasin kategorise: *invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veterane të luftës, si dhe të semurë para dhe tetraplegjik*. **Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.**
- b. Pronat e shtetit dhe të njesive të qeverisjes vendore që perdoren për qëllime jofitimprurse.
- c. Ndertesa banimi që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të pa liberalizuara.
- d. Ndertesa që perdoren nga komunitete fetare.

Perjashtohen nga pagimi i takses mbi token bujqesore.

a. Taksa paguesit që i perkasin kategorise: *Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veterane të luftës sidhe të semurë para dhe tetraplegjik . **Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.**

b. Siperfaqet e tokave bujqesore që mbillen me kultura dru frutore dhe vreshtari për 5 vitet e para nga casti i mbjelljes. **(Kjo e konfirmuar nga drejtoria e bujqesise dhe ushqimit).**

**Pergj. Taksa e Tarifave Vendore
Rakip Skuqi**

**Pergj. Shërbime Publike
Sokol Bakalli**

**Pergj. Inspektoriati Ndertimor
Erjon Nito**

**Per Policine Bashkiake
Ruzhdi Juba**

**Per Sektorin Finances
Fatmir Murati**

KRYETARI BASHKISE

Beqir NUREDINI